



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i Modulit: PËRKTHIM AUTOMATIK DHE PËRDORIMI I MJETEVE TEKNOLOGJIKE CAT (KSHK 7, Kualifikim për të nxënësit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Trajnim i drejtëpërdrejtë, online dhe i kombinuar

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: “Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

Kohëzgjatja e programit të modulit: 30 orë

- 10 orë trajnim i drejtëpërdrejtë ose online (3 ditë trajnimi)
- 5 orë studim i literaturës, materialit përkatës
- 15 orë përgatitje individuale për kryerjen e detyrave

Nr. i krediteve: 3 ECTS

REZULTATET E TË NXËNIT:

Për t’iu përgjigjur nevojave të një tregu përkthimi gjithnjë e më të ndërlikuar, ky modul, me karakter tërësisht praktik, synon të shkojë përtej kompetencave gjuhësore duke zhvilluar kompetenca në përdorimin e mjeteve teknologjike CAT (përkthimi me ndihmën e kompjuteri) si dhe në shfrytëzimin e duhur të përkthimit automatik

OBJEKTIVAT E MODULIT:

Në fund të këtij moduli, publiku i trajnuar duhet:

1. Të jetë në gjendje të vlerësojë në mënyrë kritike avantazhet dhe disavantazhet e mjeteve teknologjike CAT (përkthimi i asistuar nga kompjuteri) dhe efektet e tyre në përkthim.
2. Të kuptojë nevojat e industrisë së përkthimit në lidhje me përdorimin aplikimet e teknologjisë së përkthimit dhe të vlerësojë përshtatshmërinë e mjeteve teknologjike të përkthimit në një sërë kontekstesh të ndryshme për lloje të ndryshme tekstesh.
3. Të ketë njohuritë praktike të nevojshme për të përkthyer si duhet me Softuerin Trados.
4. Të përdorë përkthimin automatik dhe të përvetësojë teknikat e post-redaktimit.

KONCEPTET KRYESORE:

1. Mjete teknologjike
2. Programi kompjuterik TRADOS
3. Përkthimi automatik
4. Post-redaktim



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**